



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI**

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d, 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale të nenit 7, paragrafi 3 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2016, mori,

### **VENDIM**

#### **PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, QENDRËN PËR GRUMBULLIMIN RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PEMËVE DHE PERIMEVE NË FSHATIN SFEÇËL**

##### **Neni 1**

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratim paraprak të Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së Komunës, Qendrën për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël në sipërfaqe 470 m<sup>2</sup>, së bashku me njësinë kadastrale – parcelë P-71712072-00633-3 në sipërfaqe 1710 m<sup>2</sup> Zona kadastrale Sfeçël.

##### **Neni 2**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të objektit në pronësi të Komunës është ushtrimi i veprimtarisë të përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi.

##### **Neni 3**

Objekti jepet në shfrytëzim afatshkurtër për periudhën prej 15 viteve.

##### **Neni 4**

Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmesë konkurrencës së hapur publike përkatësisht ankandit publik, konform Rregullores (QRK) 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

##### **Neni 5**

Komisioni i ngritur nga Kuvendi, pas zbatimit të procedurave të konkurrencës së hapur publike, Kryetarit të Komunës i dërgon ofertën e përzgjedhur për lidhjen e kontratës me të cilën rregullohen të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës.

##### **Neni 6**

Zbatimin e Vendimit e bën Komisioni vlerësues për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

##### **Neni 7**

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-006-93841**  
**Podujevë,**  
**28 dhjetor 2016**





# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVE

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Sfeqël

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71712072-00633-3	Pracelë / Parcela / Parcel	2180,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 29.12.2016

Koha/ Vreme/ Time: 02:19:28

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

*M. Di*

Aprovoi/Usvoji/Approved: MCO PODUJEVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



*[Signature]*